

Numri i Dosjes: KSC-BC-2020-07
Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Vendos: Paneli i Gjykatës së Apelit

Administratore: Dr Fidelma Donlon

Data: 2 nëntor 2020

Gjuha: anglishte

Klasifikimi: Publik

Njoftim për apelim të ndërmjetëm në emër të Hysni GUCATIT (“Apeluesi”)

Prokurori i Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësi për Hysni Gucatin

Xhonatan Elistan Ris QC

Mbrojtësi për Nasim Haradinajn

Bastian Martens

NJOFTIM PËR APEL TË NDËRMJETËM NË EMËR TË
HYSNI GUCATIT (“APELUESI”)

HYRJE

1. Më 29 shtator 2020, apeluesi paraqiti një mocion ku kërkoi lirim nga paraburgimi¹.
2. Me vendimet e datës 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm refuzoi ta lironte apeluesin nga paraburgimi².
3. Në përputhje me nenet 41(10) dhe 45(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, Ligjit Nr. 05/L-053 (“Ligji”), dhe rregullën 58(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës, KSC-BD-03/Rev3/2020 (“Rregullorja”), apeluesi apelon kundër vendimeve të Gjykatësit të Vetëm të datës 27 tetor 2020 në të cilat refuzoi ta lirojë Apeluesin nga paraburgimi.

E DREJTA PËR APEL

4. Neni 41(10) i Ligjit parasheh që, deri në aktgjykimin përfundimtar ose deri në lirim, palët mund të apelojnë kundër vendimeve për paraburgim para panelit të Gjykatës së Apelit.

¹ “Kundërshtim i ligjshmërisë së srrëstitimit në pajtim me nenin 41(2): Fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm” KSC-BC-2020-07/F00034 në paragrafin 17 dhe “Kërkesë për dorëzani” KSC-BC-2020-07/F00038 në paragrafin 1.

² “Vendim mbi kundërshtimet e Mbrojtjes” KSC-BC-2020-07/F00057 në paragrafin 31 dhe “Vendim mbi kërkesën për dorëzani” KSC-BC-2020-07/F00059 në paragrafin 21.

5. Neni 45(2) i Ligjit konfirmon se apelet e ndërmjetme janë vetvetiu të lejueshme në lidhje me vendimet ose urdhrat për mbajtje në paraburgim.
6. Rregulla 58(1) e Rregullores rithekson: “vendimet në lidhje me mbajtjen në paraburgim mund të apelohe në Gjykatën e Apelit, në përputhje me nenin 45(2) të Ligjit”. Vlen rregulla 170(1) e Rregullores³ e cila parasheh se apeluesi mund të paraqesë apelim brenda 10 ditës pas vendimit të kontestuar.
7. E drejta e apelit në çështjen aktuale është pranuar deri më tani:
 - a. Fletarrestimi kundër apeluesit⁴ në paragrafin 10 thotë se “në momentin e arrestimit, z. Gucati ka të drejtë në bazë të nenit 41(2) dhe (5) të Ligjit, të kundërshtojë ligjshmërinë e arrestimit të tij, të urdhrat të transferimit dhe të kushteve të paraburgimit para Gjykatës të Vetëm dhe ka të drejtë të apelojë para Dhomës së Specializuar të Gjykatës së Apelit”;
 - b. Gjatë seancës së 1 tetorit 2020, Gjykatësi i Vetëm konfirmoi se apeluesi ishte aktualisht në paraburgim, duke iu referuar nenit 21(5) të Ligjit⁵, dhe e informoi Apeluesin se⁶ “keni të drejtë të kundërshtoni ligjshmërinë e arrestimit tuaj dhe të kërkonte rishikim të vendimeve për paraburgim, dhe të apelonit vendimet drejtpërdrejtë para Gjykatës së Apelit”; dhe

³ Shih rregullën 58(2) të Rregullores.

⁴ “Fletarrestim për Hysni Gucatin” KSC-BC-2020-07/F00012/A01/RED

⁵ Transkript; Paraqitja e Parë e Hysni Gucati 1 tetor 2020 në faqe 14 rreshtat 3 deri 5

⁶ Transkript; Paraqitja e Parë e Hysni Gucati 1 tetor 2020 në faqe 13 rreshtat 2 to 4

- c. ZPS-ja, në dokumentin me titull, "Përgjigje përmbledhëse e Prokurorisë ndaj mocioneve në kundërshtim të ligjshmërisë së arrestimit dhe kërkesës për lirim" e datës 9 tetor 2020, thekson "ekzistimin e të drejtës për apel të vendimeve për paraburgim (neni 45)"⁷.

PIKA E PARË E APELIT – ARRESTIMI DHE PARABURGIMI I APELUESIT NUK KANË QENË TË LIGJSHËM DHE DUHET TË URDHËROHET LIRIMI NË PËRPUTHJE ME NENIN 41(2) TË LIGJIT

8. Apeluesi e kundërshton ligjshmërinë e arrestimit të tij në pajtim me nenin 41(2) të Ligjit.

9. Neni 41(2) i ligjit parasheh:

"Çdo person që privohet nga liria me anë të arrestimit ose paraburgimit ka të drejtë ... të paraqesë ankesë lidhur me ligjshmërinë e arrestimit të tij ... dhe që ajo ankesë të vendoset me shpejtësi nga Dhomat e specializuara dhe nëse ai paraburgim nuk është i ligjshëm, të urdhërohet lirimi i tij ose saj".

10. Fletarrestimi i datës 24 shtator 2020 u lëshua nga Gjykatësi i Vetëm i caktuar nga Kryetarja e Dhomave të Specializuara në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit.⁸

11. Neni 33(2) i Ligjit parasheh caktimin e gjykatësve *përveç të Gjykatësit të Procedurës Paraprake*.

⁷ "Përgjigje përmbledhëse e Prokurorisë ndaj mocioneve të Mbrojtjes që kundërshtojnë ligjshmërinë e arrestimit dhe kërkojnë lirimin" KSC-BC-2020-07/F00045 në faqe 2 fusnota 11

⁸ "Fletarrestim për Hysni Gucatin" KSC-BC-2020-07/F00012/A01/RED në faqe 1

12. Është thënë se fletarrestimi është lëshuar në pajtim me nenin 39(3) të Ligjit.⁹
13. Neni 39(3) i Ligjit i jep *gjykatësit të procedurës paraprake* kompetencë për të lëshuar fletarrestime për arrestimin ose transferimin e personave në Dhomat e Specializuara (siç është pranuar nga Gjykatësi i Vetëm në paragrafin 8 të vendimit mbi kërkesën për fletarrestime dhe urdhra për transferim të datës 24 shtator 2020¹⁰).
14. Neni 39(3) nuk parasheh kompetenca për lëshimin e fletarrestimeve të tilla për gjykatësit e tjerë, përveçse për Gjykatësin e Procedurës Paraprake.
15. Meqë gjykatësi i procedurës paraprake caktohet vetëm pas paraqitjes së aktakuzës (shih nenin 33(1)(a) të Ligjit), kompetenca sipas nenit 39(3) të Ligjit për të lëshuar fletarrestim për arrestimin dhe transferimin a një personi në Dhomat e Specializuara, mund të hyjë në veprim vetëm pas paraqitjes së aktakuzës.
16. Rregulla 85(1) e Rregullores konfirmon se funksionet sipas nenit 39 të Ligjit ushtrohen nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake: “Bazuar në nenin 33(1)(a) të Ligjit, Kryetari cakton një gjykatës të procedurës paraprake për kryerjen e funksioneve të përcaktuara në nenin 39 të Ligjit”.
17. Që nga 27 tetori 2020, data e vendimit të Gjykatësit të Vetëm që është objekt i apelimit, nuk është paraqitur aktakuzë për këtë rast, dhe nuk është caktuar Gjykatësi i Procedurës Paraprake me kompetencë që të lëshojë fletarrestim sipas nenit 39 të Ligjit¹¹. Përkundër qëllimit të shpallur publikisht të ZPS-së që

⁹ “Fletarrestim për Hysni Gucatin” KSC-BC-2020-07/F00012/A01/RED në faqe 1

¹⁰ “Vendim mbi kërkesën për fletarrestim dhe urdhër për transferim” KSC-BC-2020-07/F00012

¹¹ “Vendim mbi kundërshtimet e Mbrojtjes” KSC-BC-2020-07/F00057 në paragrafin 43

të paraqesë aktakuzë deri më 31 tetor 2020¹², apeluesi nuk ka dijeni nëse është paraqitur aktakuzë deri më sot.

18. Rrjedhimisht, argumentohet se fletarrestimi është lëshuar pa autoritet ligjor në ato rrethana.

19. Deklarata më lart është në përputhje me mendimin e redaktorëve të ditur të Archbold International Criminal Courts: Practice, Procedure and Evidence, botimi i pestë në paragrafin 6-265 (faqe 345)¹³.

Para Tribunaleve ad hoc dhe gjykatave speciale, lëshimi i fletarrestimit mund të bëhet vetëm pas konfirmimit të aktakuzës"

[theksimi i shtuar – shih gjithashtu paragrafin 6-130 në faqe 279]

20. Sipas Archbold International Criminal Courts: Practice, Procedure and Evidence, botimi i pestë në paragrafin 6-266 (faqe 345-346) procedura për lëshimin e fletarrestimit është si në vijim:

"Kur hetimet e bindin Prokurorin të konstatojë se ekzistojnë prova prima facie, Prokurori përgatit aktakuzën që përmban një paraqitje të shkurtër të fakteve dhe krimeve për të cilat i akuzuari (shih ... neni 38(4) i Ligjit për DHSKZP-në). Gjykatësi kujdestar ose gjykatësi shqyrtues e shqyrton aktakuzën. Nëse bindet se Prokurori e ka demonstruar rastin prima facie, gjykatësi i caktuar e konfirmon aktakuzën (shih ... neni 39(2) të Ligjit për DHSKZP-në). Vetëm atëherë gjykatësi kujdestar ose gjykatësi shqyrtues mund të lëshojë fletarrestimin (shih ... neni 39(3) i Ligjit për DHSKZP-në).

[theksimet janë shtuar]

¹² Transkript, Paraqitja e Parë e Hysni Gucatit 1 tetor 2020 në faqe 15 rreshtat 21 to 22

¹³ Shih Shtojca 1

21. Në përputhje me si më lart, personi që është objekt i fletarrestimit gëzon 'Të drejtat e të akuzuarit' sipas nenit 21 të Ligjit (meqenëse fletarrestimi kundër apeluesit i referohet paragrafit 8).
22. Në rastin kur fletarrestimi lëshohet pas konfirmimit të aktakuzës në pajtim me nenin 39(2) të Ligjit, personi që është objekt i tij faktikisht gëzon të drejtat e të akuzuarit sipas nenit 21, meqenëse në atë fazë dhe vetëm në atë fazë ai ka statusin e të akuzuarit, (shih rregullën 86(6)(a) të Rregullores: "Me konfirmimin e cilësdo prej akuzave të aktakuzës: (a) i dyshuari bëhet i akuzuar; dhe (b) gjykatësi i procedurës paraprake mund të lëshojë fletarrestimin ... çfarëdo vendimi apo urdhri të paraparë në nenin 39(3) të Ligjit").
23. Neni 41(6) i Ligjit të cilit i referohet fletarrestimi, nuk krijon kompetenca shtesë për të urdhëruar arrestimin, por vetëm ofron kritere mbi të cilat mund të ushtrohet çfarëdo kompetence tjetër për urdhërimin e arrestimit (konkretisht, kompetencat që i jepen Prokurorit të Specializuar sipas nenit 38(2) të Ligjit dhe gjykatësit të procedurës paraprake në nenin 39(3) të Ligjit, që gjithashtu neni 40(6)(a) ia jep edhe trupit gjykues.
24. Megjithëse rregulla 53 e Rregullores të cilës gjithashtu i referohet fletarrestimi, përcakton se 'një panel mund të lëshojë fletarrestim nëse bindet se janë plotësuar kushtet e përcaktuara në nenin 46(6) të ligjit', kjo rregull nuk i jep dhe nuk mund t'i japë gjykatësit të vetëm kompetenca për të lëshuar urdhër për arrestimin e një personi. 'Paneli' përkufizohet si 'cilido panel/trup gjykues, ose gjykatës i caktuar në një çështje në përputhje me nenin 25(1) dhe nenin 33 të Ligjit, përveç nëse është përcaktuar ndryshe' (shih rregullën 2 të Rregullores). Sipas nenit 25(1), gjykatësi i vetëm caktohet vetëm kur 'është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve të gjykatësit të procedurës paraprake'

(lëshimi i fletarrestimeve është funksion i gjykatësit të procedurës paraprake sipas nenit 39(3) të Ligjit) ose 'kur është e nevojshme për ushtrimin e funksioneve që kërkohen me Ligj.' Meqenëse me Ligj nuk kërkohet që gjykatësi i vetëm të ushtrojë funksionin e lëshimit të fletarrestimit, gjykatësi i vetëm nuk përfshihet në përkufizimin e termit 'panel' në lidhje me rregullën 53 të Rregullores. Në thelb, rregulla 53 thjesht përcakton se çfarë informacioni mund të përfshihet në fletarrestim kur janë plotësuar kriteret për lëshimin e fletarrestimit nga gjykatësi i procedurës paraprake ose trupi gjykues.

25. Gjithashtu, edhe pse rregulla 57 e Rregullores (të cilës nuk i referohet fletarrestimi) parasheh që i dyshuari mund të jetë në paraburgim para caktimit të gjykatësit të procedurës paraprake dhe që paraburgimi i tij shqyrtohet nga gjykatësi i vetëm i caktuar sipas nenit 33(2), kjo rregull nuk i jep dhe nuk mund t'i japë gjykatësit të vetëm kompetencë për të lëshuar fletarrestim në radhë të parë për arrestimin e të dyshuarit.
26. Në realitet, rregulla 57 e Rregullores merret vetëm me paraburgimin pasi Prokurori i Specializuar të ketë ushtruar kompetencën e padyshimtë që ka për të arrestuar një person gjatë fazës hetimore, siç parashihet konkretisht në nenin 35(2)(h) të Ligjit. Edhe pse rregulla 57(1) parasheh që Gjykatësi i Vetëm i caktuar në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit mund të *rishikojë* paraburgimin e një të dyshuari pas arrestimit të tij/saj nga *Prokurori i Specializuar* dhe të shqyrtojë kërkesën për zgjatje të paraburgimit, një zgjatje e tillë mund të miratohet vetëm kur "përligjet prej masave hetimore që do të ndërmerren prej Prokurorit të Specializuar".
27. Pas arrestimit nga Prokurori i Specializuar gjatë fazës hetimore, zgjatja e paraburgimit sipas rregullës 57 nuk mund të bëhet për asnjë arsye tjetër

përveçse atyre në nenin 41(6)¹⁴.

28. Efektet e nenit 35(2)(h) të Ligjit dhe rregullës 57(1) të Rregullores janë vetëm për të saktësuar se gjatë fazës hetimore vetëm Prokurori i Specializuar (jo Dhomat e Specializuara) mund të urdhërojë arrestimin dhe paraburgimin e të dyshuarve për një periudhë jo më të gjatë se 48 orë pa zgjatje të mëtejshme, dhe zgjatja mund të miratohet vetëm për aq sa nevojitet për marrjen e masave hetimore konkrete.
29. Rregulla 57 nuk parasheh kompetencë për Gjykatësin e Vetëm që të lëshojë fletarrestim, ose të autorizojë paraburgimin për periudhë më të gjatë se që justifikohet prej masave hetimore që do të ndërmerren nga Prokurori i Specializuar.
30. Parashtrohet se Ligji është i qartë: e vetmja kompetencë që u jepet Dhomave të Specializuara për të urdhëruar arrestime përcaktohet në nenin 39(3) të Ligjit dhe i jepet Gjykatësit të Procedurës Paraprake (dhe trupit gjykues që ushtron funksionet ose kompetencat e gjykatësit të procedurës paraprake përmes nenit 40(6)).
31. Meqenëse nuk është lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake në çështjen në fjalë, por nga Gjykatësi i Vetëm, fletarrestimi është lëshuar pa autoritet të ligjshëm. Rrjedhimisht, pohojmë se paraburgimi i apeluesit në përputhje me atë fletarrestim nuk është i ligjshëm dhe ai duhet të lirohet në përputhje me nenin 41(2) të Ligjit.

¹⁴ Shih rregullën 57(1) të Rregullores

PIKA E DYTË E APELIT- APELUESIT DUHET T'I MIRATOHET DORËZANIA

32. Pa paragjykim ndaj pikës së parë të apelit, parashtrohet se apeluesit duhet t'i miratohet dorëzania.

33. Neni 41(6) i Ligjit parasheh që paraburgimi urdhërohet vetëm kur ka arsye të artikulueshme për të besuar se:

- i. ekziston rreziku i arratisjes;
- ii. personi do të shkatërrojë, fshehë, ndryshojë ose falsifikojë prova të krimit, ose rrethana konkrete tregojnë se do të pengojë kryerjen e procedimit penal duke ndikuar te dëshmitarët, viktimat ose bashkëkryesit; ose
- iii. pesha e krimit ose mënyra dhe rrethanat në të cilat është kryer dhe karakteristikat personale, sjellja e personit në të kaluarën, mjedisi dhe kushtet në të cilat personi jeton ose rrethana të tjera personale janë tregues të rrezikut se ai person do të përsërisë veprën penale, do të përfundojë një krim të tentuar ose do të kryejë një krim të cilin ka kërcënuar se do ta kryejë.

34. Neni 41(2) i Ligjit përcakton se Dhomat e Specializuara mund të urdhërojnë një varg masash, ndër të cilat dorëzanimi, kushtet e vendbanimit, duke përfshirë paraburgimin shtëpiak, ndalimin për t'iu afruar vendeve ose personave të caktuar, dhe kushtet për paraqitje në stacione policore si alternativë e mbajtjes në paraburgim për të siguruar praninë, parandalimin e përsëritjes së krimit ose për të siguruar kryerjen e suksesshme të procedimit penal.

35. Si rrjedhojë, kur masat alternative u përgjigjen kushteve që përmban neni 41(6) i Ligjit, paraburgimi nuk mund të justifikohet më.

36. Në rastin aktual, parashtruesi i kërkesës ka propozuar dorëzani me këto kushte¹⁵:

- a. garanci prej 5,000 eurosh
- b. dorëzim të pasaportës
- c. kushtin për të jetuar dhe fjetur çdo natë në shtëpinë e tij
- d. raportim ditor në zyrat e policisë së EULEX-it
- e. kushtin që të mos kontaktojë drejtpërdrejtë ose tërthorazi asnjë person me të cilin gjykata mendon se është e përshtatshme për t'ia kufizuar kontaktet
- f. kushtin që të mos t'i afrohet më afër se 100 metra Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

37. Gjykatësi i Vetëm pranoi se kushtet e propozuara e adresojnë në mënyrë të përshtatshme rrezikun e arratisjes¹⁶, por konstatoi se ekziston rreziku që apeluesi mund të pengojë zhvillimin e procedimit dhe/ose të kryejë krime të tjera¹⁷.

¹⁵ "Kërkesë për dorëzani" KSC-BC-2020-07/F00038 në paragrafin 5

¹⁶ "Vendim mbi kërkesën për dorëzani" KSC-BC-2020-07/F00059 në paragrafët 15 dhe 16

¹⁷ "Vendim mbi kërkesën për dorëzani" KSC-BC-2020-07/F00059 në paragrafët 18 dhe 20

38. Argumentohet se rreziku që apeluesi mund të pengojë zhvillimin e procedimit dhe/ose të kryejë krime të tjera, adresohet në mënyrë të duhur me këto kushte.
39. Në radhë të parë, shkalla e një rreziku të tillë duhet të vlerësohet drejt në këto rrethana.
40. Në konferencën për shtyp të 7 shtatorit 2020, apeluesi foli pak dhe nuk ka zbuloi të dhëna të dëshmitarëve. Materiali ishte dorëzuar atë mëngjes dhe apeluesi nuk e kishte parë¹⁸.
41. Në të njëjtën datë, Gjykatësi i Vetëm autorizoi konfiskimin e dokumenteve të pranuar nga OVL-UÇK-ja atë ditë, dhe e urdhëroi apeluesin, OVL-UÇK-në dhe çdo individ që posedonte ato dokumente dhe/ose përmbajtjen e tyre, që të mos kopjonin në asnjë lloj forme dhe të mos shpërndanin me asnjë mjet komunikimi, ato dokumente dhe përmbajtjen e tyre¹⁹. Gjykatësi i Vetëm gjithashtu e paralajmëroi apeluesin që të mos pengonte zbatimin e vendimit aktual ose të shkelte kushtet e tij²⁰. Sidoqoftë, apeluesi nuk ishte i pranishëm kur u krye sekuestrimi dhe urdhri e paralajmërimi nuk iu përcollën atij.²¹ Sido që të jetë, nuk ka pasur shkelje as të urdhrit në paragrafin 22, as të paralajmërimit në paragrafin 25 të vendimit për autorizimin e sekuestrimit të datës 7 shtator 2020.
42. Më 16 shtator 2020, në zyrat e SHVL-së të UÇK-së, në mënyrë të papritur u

¹⁸ "Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestim edhe urdhrave lidhur me të" KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01 faqe 2

¹⁹ "Vendim për autorizim të sekuestrimit" KSC-BC-2020-07/F00001 në paragrafin 22

²⁰ "Vendim për autorizim të sekuestrimit" KSC-BC-2020-07/F00001 në paragrafin 25

²¹ "Raport i Prokurorisë në pajtim me Vendimin KSC-BC-2018-01/F00121 [më vonë është protokolluar si KSC-BC-2020-7/F00001]" KSC-BC-2020-07/F00008 në faqet 1 deri 2

dorëzua më shumë material²². Apeluesi përsëri foli shumë pak dhe nuk zbuloi të dhëna të dëshmitarëve. Në të vërtetë, dokumentet nuk përmbanin emra të dëshmitarëve (së paku sipas dijenisë së apeluesit)²³. Apeluesi i ftoi autoritetet që të sekuestronin materialin²⁴.

43. Më 17 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm autorizoi sekuestrimin e dokumenteve të marra nga OVL-UÇK më 16 shtator dhe lëshoi urdhër dhe paralajmërim të ngjashëm me atë që kishte lëshuar në urdhrin e mëparshëm për sekuestrim²⁵. Nuk ka pasur shkelje të urdhrin në paragrafin 22, as të paralajmërimit në paragrafin 25 të vendimit për autorizimin e sekuestrimit të datës 17 shtator 2020.

44. Më 22 shtator 2020, u dorëzuan papritmas edhe dokumente të tjera në zyrat e OVL-UÇK -së. Në konferencën e tretë për shtyp, apeluesi i ftoi autoritetet të hetonin nxjerrjen e materialeve, deklaroi se OVL-UÇK -ja nuk do të zbulonin emrat që përmbanin dokumentet²⁶, as nuk përmendi emra e nuk bëri publike asnjë dosje. Referenca për dokumentet e publikuara në faqen 14 të Shtojcës 1 të Kërkesës për fletarrestime dhe urdhrave lidhur me të duhet të shihen në kontekstin e duhur – si pjesë e thirrjes drejtuar ZPS-së që të ndalë rrjedhjen e dokumentacionit (shënim: përkthimi në Shtojcën 1 është vetëm ‘përkthim i përafërt’²⁷).

²² “Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime dhe urdhrave të lidhura me to” KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01 faqe 7

²³ “Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime dhe urdhrave të lidhura me to” KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01 faqe 7 faqe 8

²⁴ “Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime dhe urdhrave të lidhura me to” KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01 faqe 13

²⁵ “Vendim për autorizim të sekuestrimit” KSC-BC-2020-07/F00007 në paragrafët 22 dhe 25

²⁶ “Shtojca 1 e Kërkesës për fletarrestime dhe urdhrave të lidhura me to” KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A01 faqe 13 deri 14 dhe faqe 24.

²⁷ “Kërkesë Urgjente për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to’ parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-07/00009 i datës 22 shtator 2020 me shtojcat publike 1-2” KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED në faqe 3 shënim 6.

45. Dokumentet e marra në zyrat e OVL-UÇK -së më 22 shtator 2020 u konfiskuan nga ZPS-ja të njëjtën ditë²⁸. Ditën e nesërme, ZPS-ja kërkoi urdhër nga Gjykatësi i Vetëm që “z. Gucati, SHVL e UÇK-së dhe çdo përfaqësues, anëtar ose përfaqësues i OVL-UÇK -së (i) të njoftojnë menjëherë ZPS-në nëse kanë në posedim ose marrin në të ardhmen dokumente të tjera që duket se janë konfidenciale ose jopublike dhe kanë lidhje me Task Forcën Speciale Hetimore (TFSH) ose hetimet e ZPS-së ose dëshmitarët, ose proceset e Dhomave të Specializuara të Kosovës (‘DHSK’); dhe (ii) pa autorizimin e ZPS-së ose Gjykatësit të Vetëm, të mos incizojnë ose kopjojnë në asnjë lloj forme, e të mos shpërndajnë me asnjë mjet komunikimi, të dokumenteve të tilla ose përmbajtjes së tyre”²⁹. ZPS-ja nuk kishte kërkuar urdhër me këto kushte më herët dhe, në fakt, Gjykatësi i Vetëm nuk ka lëshuar një urdhër të tillë.
46. Nuk është e qartë se sa materiale nga ato që përmenden në lidhje me 7, 16 dhe 22 shtator 2020, nuk kanë qenë që më parë materiale publike. Sigurisht, sa i përket 16 shtatorit 2020, është thënë se informacioni ishte bërë publik që më parë³⁰.
47. Për më tepër, nuk ka pretendime se është përdorur forca. Nuk ka pretendime se ndonjë person ka pësuar dëmtime konkrete. Nuk ka pretendime për mosdhënie deklarate ose për dhënie deklarate të rreme ose për mosdhënie të informacionit të vërtetë policisë, prokurorit ose gjykatësit për shkak të veprimeve të apeluesit.

²⁸ “Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe urdhra të lidhura me to’ parashtrim i protokolluar KSC-BC-2020-07/00009 i datës 22 shtator 2020 me shtojcat publike 1-2” KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED në paragrafin 9.

²⁹ “Njoftim i Prokurorisë dhe kërkesa të lidhura me të” KSC-BC-2020-07/F00010/RED në paragrafin 7

³⁰ “Shtojca 2 e Kërkesës për Fletarrestime dhe Urdhra të Lidhura me to” KSC-BC-2020-07/F00009/CONF/RED/A02 në faqe 7.

48. *Maksimumi* i dënimit me burgim për shkelje të fshehtësisë së procedurave gjyqësore në rrethanat e pretenduara në fletarrestim është një vit burgim.
49. *Maksimumi* i dënimit me burg për veprën penale të hakmarrjes në rrethanat e pretenduara në fletarrestim është tre vjet burgim.
50. Edhe pse maksimumi i dënimit me burg për veprën penale të frikësimit gjatë procedurave penale është 10 vjet (minimumi është vetëm dy vjet), kufiri më i lartë i këtij dënimi duhet të rezervohet vetëm për rastet ku është përdorur forca dhe kërcënim konkret (gjë që nuk pretendohet në këtë rast).
51. Apeluesi është njeri me karakter të mirë deri më tani dhe u është bindur oficerëve të ZPS-së gjatë arrestimit dhe transportimit³¹.
52. Siç e ka konfirmuar edhe Gjykatësi i Vetëm, ai ka lidhje të forta familjare dhe në komunitetin e qytetit ku banon³². Apeluesi është njeri familjar, dhe përgjegjësitë e tij përfshijnë kujdesin për nënën plakë gjatë kësaj kohe të vështirë, e cila nuk ndjehet mirë dhe është e dobët.
53. Në rrethanat e përshkruara më lart, argumentohet se Gjykatësi i Vetëm ka gabuar në konstatimin se ekzistonte rrezik, i cili nuk mund të adresohet me asnjë kusht, që Apeluesi mund të pengojë zhvillimin e procedimit/kryejë vepra penale të tjera.
54. Apeluesi ka propozuar kushtin për të mos kontaktuar drejtpërdrejtë ose tërthorazi me cilindo person me të cilin gjykata mendon se duhet të kufizohen kontaktet dhe kushtin që të mos u afrohet zyrave të Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës më afër se 100 metra.

³¹ "Raport për arrestimin dhe transferimin e Hysni Gucatit në objektin e paraburgimit"
KSC-BC-2020-07/F00031/RED në paragrafin 8

³² "Vendim mbi kërkesën për dorëzani" KSC-BC-2020-07/F00059 në paragrafin 14

Argumentohet se këto kushte adresojnë çfarëdo rreziku të mbetur që apeluesi të marrë, ose të shpërndajë informacion konfidencial dhe jopublik duke komunikuar me mediat ose me veteranët e UÇK-së ose duke e publikuar materialin vetë. Nëse është e nevojshme, këto kushte mund të zgjerohen – duke përfshirë për shembull edhe kërkesën që apeluesi të mos hyjë në Prishtinë, dhe/ose kërkesën që të ketë vetëm një pajisje elektronike për komunikim, hollësitë e të cilit do t’ia bënte të ditura ZPS-së.

55. Gjykatësi i Vetëm nuk i ka adresuar kushtet konkrete të propozuara në vendimin mbi kërkesën për dorëzani. Kushte të tilla të bashkëngjitura dorëzansë nuk janë vetëm ‘sigurime personale’, por urdhra nga Dhomat e Specializuara, shkelja e të cilave do ta bënte Apeluesin përsëri objekt të paraburgimit dhe dënimeve të tjera të mundshme sipas nenit 15(2) të Ligjit dhe nenit 401 të Kodit Penal të Kosovës të viti 2012.
56. Duke e hedhur poshtë parashtrimin se apeluesi do të respektonte kushtet e nevojshme, Gjykatësi i Vetëm gaboi në deklarinimin se apeluesi nuk i kishte respektuar urdhrat e Gjykatësit të Vetëm³³. Urdhrat e dhënë nga Gjykatësi i Vetëm më 7 dhe 17 shtator 2020 kishin të bënin konkretisht me dokumentet e marra përkatësisht më 7 dhe 16 shtator 2020 dhe në fakt këto urdhra u respektuan. I vetmi urdhër me fushëveprim më të gjerë i kërkuar u kërkuar nga ZPS-ja vetëm më 23 shtator 2020, dhe ai urdhër nuk është lëshuar.
57. Në rrethanat e përshkruara më lart, argumentojmë se Gjykata e Apelit mund të bindet plotësisht se apeluesi do t’u përmbahet kushteve të dorëzansë që kërkohen për të adresuar rrezikun që apeluesi mund të pengojë zhvillimin e procedimit/kryejë vepra penale të tjera.

³³ “Vendim mbi kërkesën për dorëzani” KSC-BC-2020-07/F00059 në paragrafët 16 dhe 17

58. Për më tepër, parashtrojmë se Gjykatësi i Vetëm ka nxjerrë përfundimin e gabuar se “bashkëpunimi i z. Gucati gjatë arrestimit, mungesa e aktakuzës, natyra jo e dhunshme e veprave penale që hetohen, mungesa e pretendimeve për kërcënime apo dëme konkrete dhe dënimet e mundshme minimale për veprat penale përkatëse” nuk “e kanë bërë vazhdimin e paraburgimit të paarsyeshëm ose të tepruar në këto rrethana”³⁴ Pikërisht për shkak të këtyre veçorive, nëse arrestimi i apeluesit dhe paraburgimi fillestar kanë qenë të ligjshëm në kundërshtim me pikën e parë të apelit, dorëzania duhet gjithsesi të miratohet këtë fazë.

Numri i fjalëve: 4,058 /në origjinal/

/nënshkrim/

Xhonatan Elistan Ris QC

Mbrojtësi i Specializuar për z. Gucati

Hju Bouden /Huw Bowden/

Bashkëmbrojtësi i Specializuar për z. Gucati

2 nëntor 2020

Kardif, MB

³⁴ “Vendim mbi kërkesën për dorëzani” KSC-BC-2020-07/F00059 në paragrafin 8